



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008) dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më, 10.04.2020 merr këtë

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PAKOS EKONOMIKE EMERGJENTE

I.

MIRATOHET Vendimi për pakon ekonomike emergjente.

II

Sipas pikës I të këtij vendimi, kjo pako përfshin masat, si në vijim:

1. Sigurimi i 5000 pakove higjenike, në vlerë prej 100,000 €;
2. Sigurimi i 5000 pakove ushqimore, në vlerë prej 200,000 €;
3. Pajisje shëndetësore, në vlerë prej 200,000 €;
4. Buxhet për dezinfektim – deri në 200,000 €;
5. Të gjitha bizneset të cilat janë me qira në lokalet që janë në pronësi të ndërmarrjeve publike lokale të Prishtinës, do të lirohen nga qiraja prej ditës kur kanë filluar masat restriktive, për dy muaj rrësht, për pjesën që nuk mbulohet nga Qeveria (pakoja ekonomike). Me këtë vendim lirohen bizneset për një periudhë njëmuore, ndërsa për muajin e dytë autorizohen aksionarët që ta vazhdojnë lirimin nga pagesa në qoftë se vazhdojnë masat restriktive. (Ndërmarrja Publike Banesore dhe Pallati i Rinisë, duhet të raportojnë për gjendjen financiare dhe mundësinë e përballimit të kostos nga fushëveprimi i tyre);
6. Të gjitha bizneset në Komunën e Prishtinës, që nuk mund ta ushtrojnë veprimtarin për shkak të masave të qeverisë së Republikës së Kosovës, me rastin e COV-19, e të cilat paguajnë taksë për shfrytëzimin e hapësirës publike, lirohen nga pagesa për një vit (një sezon verore dhe një dimër), Liriimi nga taksa mund të aplikohet në borxhin që e kanë ndaj Komunës apo nga taksa në të ardhmen;

7. NPL Stacioni i Autobusëve do të subvencionohet për paga për muajin prill, në vlerë prej 80,000 euro. Stacioni ka ndërprerë funksionimin me ndalimin e trafikut ndérurban, andaj ka vështirësi në sigurimin e pagave;
8. Çerdhet me bazë në komunitet paguajnë pagat nga të hyrat e pagesës së prindërve. Këto çerdhe do të subvencionohen për pagat e punëtorëve, kostoja e të cilave është 50 mijë euro në muaj;
9. Lirohen nga pagesa të gjithë prindërit e fëmijëve në çerdhet publike për periudhën derisa çerdhet qëndrojnë të mbyllura;
10. NPL “Prishtina Parking” ka filluar të funksionojë, tashmë ka angazhuar personel, si dhe ka transferuar punëtorët e parkingut prapa Pallatit të Rinisë. Ndërmarrja subvencionohet me 50 mijë €;
11. Subvencione për sport, në vlerë prej 100,000 €, për klubet në vështirësi për shkak të mosfunkcionimit të garave;
12. Subvencione për kulturë, në vlerë prej 100,000 €, për artistët të cilët nuk kanë të hyra për shkak të gjendjes së pandemisë;
13. Katër ndërmarrje të tjera të prekura finanziarisht nga masat restriktive: “Trafiku Urban”, “Hortikultura”, “Sport Marketing” dhe “Pastrimi”, do të subvencionohen me 250,000 €, me mundësi që “NPL Pastrimi” të subvencionohet me 50,000 € shtesë.
14. Do të themelohet një program i granteve për biznese, të vetëpunësuarit, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, i cili do të ndihmojë bizneset që dëshmojnë humbjet nga masat restriktive. Vlera e këtij fondi varet nga diskutimet me Ministrinë e Financave.

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Financave dhe drejtoritë tjera relevante.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-400/04-64478/20, më 14.04.2020

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

